



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 594/Prot.
2

Tiranë, më 22/5/2014

REKOMANDIM

Nr 52, datë 22/5/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Këshilli i Qarkut Shkodër".

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 53 datë 09.04.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Këshilli i Qarkut Shkodër" me objekt: "Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të videosurvejimit (CCTV) në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Përpunimi i të dhënave personale në sistem video survejimi në ndërtesa dhe mjedise të tjera i ndryshuar".

"Këshilli i Qarkut Shkodër" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik (organ i pushtetit vendor) i cili gjatë veprimtarisë së tij mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore dhe sipas nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar ka detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale që ai kryen.

Institucioni juaj nuk ka plotësuar këtë detyrimin ligjor, ku duhet të deklaroni nëse përpunimi i të dhënave bëhet për një qëllim apo për disa qëllime, një përshkrim i përgjithshëm i masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse janë hartuar, miratuar dhe zbatohen rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur përpunimin e sigurte dhe të ligjshëm të të dhënave personale. Në njoftim deklarohet edhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të "video survejimit". Rëndësi të veçantë ka caktimi i një oficeri (ose personi të ngarkuar) sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesit, si dhe regjistrimi i tij pranë KMDP, pasi shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale.

Institucioni juaj nuk ka hartuar rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, prandaj në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, keni detyrimin të hartoni rregullore të

brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, ku të përfshihen dhe rregulla lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të "video survejimit". Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga Institucioni juaj në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale i parashikuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, nuk është realizuar. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe një mënyrë shumë efektive është informimi i subjekteve të të dhënave personale në faqen tuaj www.qarkushkoder.gov, në një rubrikë të veçantë të emëruar "*politikat e privatësisë*" (*paketë rregullash*), ku të përfshihen mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtja e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

"*Këshilli i Qarkut Shkodër*", mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale (*imazhe*) nëpërmjet përdorimit të sistemit të "video-surveimit" në ambientet e godinës ku janë vendosur zyrat e tij, si dhe në ambientin e jashtëm të godinës, ku regjistrohen imazhe video nga rruga "*pedonale*", godinat dhe lokalet pranë zyrave të kontrolluesit, të qytetarëve që kalojnë rastësisht në rrugën dhe ambientet e monitoruara. Pamjet përhapen (*në kohë reale*) në faqen e internetit www.qarkushkoder.gov.al/site/live. Institucioni juaj nuk ka përcaktuar rregulla të shkruara, për përdorimin e këtij sistemi dhe nuk ka vendosur tabela informuese për informimin e subjekteve të të dhënave për përdorimin e kamerave të "video survejimit".

Qëllimi për të cilin përdoret sistemi i "video survejimit" të rrugës "*pedonale*" dhe godinat e lokalet pranë zyrave të kontrolluesit, lidhet me promovimin turistik të qytetit. Pjesë e rëndësishme e aktivitetit publik të Institucionit tuaj është promovimi i vlerave të qytetit të Shkodrës, si një nga qytetet me vlera arkitekturore dhe historike të vendi tonë. Por ky promovim duhet të bëhet duke respektuar jetën private të qytetarëve të tij. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson bashkëpunimin e përfaqësuesve tuaj me grupin e inspektimit, si dhe zbatimin e detyrës të lënë nga ky grup. Nga ana juaj është kryer pezullimi i publikimit online në faqen www.qarkushkoder.gov.al/site/live të të dhënave personale (*imazhe*) që mblidhen, përpunohen dhe ruhen nga përdorimi i sistemit të "video survejimit".

Monitorimi dhe transmetimi në kohë reale nëpërmjet internetit apo shërbimeve të tjera të ngjashme, i imazheve të regjistruara nëpërmjet sistemit të "video survejimit", ku qytetarët janë lehtësisht të identifikueshëm nëpërmjet fytyrës bie ndesh me pikën 5/3 të Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar). Përdorimi në këtë mënyrë i sistemit të "video survejimit" në këto ambiente përbën ndërhyrje në jetën private të qytetarëve (*subjekte të të dhënave personale*), të drejtat e të cilëve janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "*Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Institucioni juaj duhet të gjejë mënyrat e duhura të përdorimit të sistemit të "video survejimit", të tilla që qytetarët që kalojnë rastësisht në rrugën dhe ambientet e monitoruara, të jenë të pa identifikueshëm në mënyrë që të respektohet privatësia e tyre, sipas kërkesave të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i

ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar (pikat 4/a/ç,d,dh, 5/4).

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, të realizohet detyrimi për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga ju si kontrollues. Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

Në faqen tuaj në internet www.qarkushkoder.gov.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë" (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

3. Në zbatim të neneve 2, 27 dhe 28 të ligjit nr. 887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar:

- mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale (imazhe) përmes përdorimit të sistemit të "video survejimit", të kryhet vetëm duke bërë të pa identifikueshëm qytetarët (subjekte të të dhënave personale) që kalojnë rastësisht në rrugën "pedonale" dhe ambientet e lokalet pranë zyrave të Institucionit tuaj.
- publikimi online në faqen www.qarkushkoder.gov.al/site/live i të dhënave personale (imazhe) të mbledhura përmes përdorimit të sistemit të "video survejimit", të kryhet vetëm duke bërë të pa identifikueshëm qytetarët (subjekte të të dhënave personale) që kalojnë rastësisht në rrugën "pedonale" dhe ambientet e lokalet pranë zyrave të Institucionit tuaj.
- në vende të dukshme të vendosen tabela informuese për publikun, lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të "video survejimit".
- të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, ku të përfshihen dhe rregulla lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve me anë të sistemit të "video survejimit".

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dëgjimit të këtij Rekomandimi.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit.. “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

